



Projektet për zhvillimin e turizmit, Ministria Ekonomi jep detajet



Ministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj. Milva Ekonomi, ka dhënë një intervistë për televizionin “Vizion Plus”, ku ka folur mbi pritshmëritë dhe objektivat e dikasterit që ajo drejton për vitin 2017, kryesisht në sektorin e turizmit, i cili këtë vit pritet të ketë ndryshime thelbësore. Pas përfundimit të programit “Rilindja Urbane”, përmes të cilit shumë qendra qytetesh u transformuan, qeveria ka gati një projekt të ri, i cili do të fokusohet në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit. Programi i rrugëve alternative, i cili parashikon investime deri në 1 miliardë dollarë të shtrirë në dy tre vite, ka si qëllim jo vetëm ndërtimin e rrugëve të reja, por lidhjen e tyre me zona dhe objekte turistike. Gjatë intervistës, Ministria Ekonomi dha detaje të këtij programi. “Po punohet për rehabilitimin e zonave turistike, në kuptimin e një rehabilitimi urban ose të një rehabilitimi të gjithë sistemeve që ndikojnë në cilësinë e turizmit. Gjithashtu, po mendohet të krijohet koncepti i atyre që quhen “hotel difuzione”, hoteli me qendër që shpërndahet me një zonë alpine, në një zonë malore, ku përdoren dhe shtëpitë e mikpritjes, si dhe krijimi i një shtëpie mikpritje mëmë, e cila do marrë përsipër të krijojë kërkesën akomoduese për të tretët. Është një nga format që ne po promovojmë në paketën “One Billion Project Financing”. Në të vërtetë, do të jetë biznesi privat, huaj ose vendas, i cili do të marrë përsipër implementimin. Por, ai do të jetë i rrethuar nga kujdesi që bën ministria dhe njësisia vendore për të bërë implementimin e projektit”, u shpreh Ministria. Lidhur me certifikimin e strukturave akomoduese, Ministria Ekonomi tha se ai do të nisë së shpejti dhe do të kalojë në disa faza. “Përsa i përket certifikimit të strukturave akomoduese, ky do të jetë një proces pak i gjatë, sepse fillon me një vetë deklaram të hoteleve apo strukturave akomoduese, verifikohet vetë deklarimi dhe pastaj bëhet certifikimi. Ky është një proces që kërkon bashkëpunim dhe bashkërendim të detyrave me strukturat akomoduese”, u shpreh znj. Ekonomi. Por, fundi i 2016 shënoi edhe përfundimin e regjistrit të koncesioneve të dhënave në Shqipëri. Ministria e MZHE-TTS bën me dije se deri më tani në këtë regjistrë janë të vendosura 107 kontrata koncesionare, por numri i tyre pritet të rritet, duke iu referuar dhe afatit se kur janë lidhur dhe duke kaluar edhe në periudha më të hershme të koncesioneve të lidhura. Krijimi i këtij regjistri tashmë i jep te drejte ministrisë që të monitorojë çdo kontratë lidhur me zbatueshmërinë e afateve të saj dhe të ndër marrë penalitete në rast se ato nuk janë respektuar.

<http://vizionplus.al/projekt-per-zhvillimin-e-turizmit/>

BSH: Ekonomia vijon trendin rritës të investime të huaja



Shqipëria vijon të regjistrojë trend në rritje për thithjen e investimeve të huaja direkte. Kjo gjë bëhet e ditur nga Banka e Shqipërisë në raportin e fundit të saj, ndërsa evidentohet se origjina e këtyre investimeve në vendin tonë vjen kryesisht nga Greqia, Holanda, Italia e Turqia, kryesisht në aktivitetet e sigurimit, industrinë nxjerrëse të hidrokarbureve, energjisë dhe telekomunikacionit. Ndërkohë që përqendrimi më i madh i ndërmarrjeve të huaja është në Tiranë. Trendi rritës për thithjen e investimeve të huaja Shqipëria e ka nisur në 2015, ku konkretisht prej vlerës 869 mln euro në 2014 flukset e IHD në 2015 shkuan në 890 mln euro. Bazuar në të dhënat zyrtare të Bankës Qëndrore, trendi rritës në 2015 ishte në vlerën e 21 mln eurove, ose me rreth 2.4 % krahasuar me një vit më parë duke arritur të mbulojnë 11.6 % të PPB. Ndërsa bazuar në të dhënat e Bankës së Shqipërisë, INSTAT dhe ministrisë së Financave, në fund të 3 mujorit të tretë të viti 2016 fluksi i IHD arriti në vlerën e 706 mln eurove. Prurjet më të mëdha në formën e investimeve direkte në Shqipëri vijnë nga hidrokarburet apo industria nxjerrëse, 53% dhe energjetika 27%.

CNN e rendit Shqipërinë në 17 destinacionet për t'u vizituar



Shqipëria konsiderohet nga media prestigjioze CNN një ndër 17 destinacionet kryesore të turizmit për vitin 2017. Në një artikull të publikuar në datën 6 Janar 2017, CNN rendit 17 vende të përzgjedhura për tu vizituar këtë vit, vende në të cilat bën pjesë edhe vendi ynë. “Ky vend i vogël mbetet një nga sekretet më të ruajtura të Europës në dy dekadat e fundit. Me diell, i lirë si destinacion, me kilometra të tëra brigjesh të pastra dhe bukuri të pandotur. Me një kulinari të ngjashme si Greqia fqinje, por gati me gjysmë çmimi, Shqipëria do të ketë një bum turistik në 2017”. Kështu e përshkruan CNN Shqipërinë, duke ftuar vizitorët që të zbulojnë vendin tonë.

<http://edition.cnn.com/2017/01/06/travel/best-places-to-visit-in-2017/index.html>

Francezja "Telerama": Shqipëria, ndër 10 destinacionet turistike të 2017



Jehona e Shqipërisë turistike vijon në një tjetër media të huaj. Opinioni publik francez, nëpërmjet të përjavshmes "Telerama", i sugjerohet të udhëtojë drejt vendit tonë, konkretisht, Tiranës. Kryeqyteti, i cili është kthyer tashmë një ndër destinacionet me tërheqëse dhe të njohura ndërkombëtarisht, tashmë promovohet edhe në mediat franceze, si Telerama. Në përshkrimin e shkurtër që i bëhet vendit tonë thuhet se, Shqipëria mund të jetë sot një destinacion turistik në rritje, pasi ajo ka asete si bregu adriatik, mundësi për sporte si hiking, si dhe një kryeqytet plot ngjyra si Tirana: Për tu zbuluar.

<http://www.telerama.fr/sortir/tirana-turin-orleans-nos-dix-destinations-preferees-pour-2017,152332.php>

OKB: 2017, viti ndërkombëtar i zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm



Viti 2017 është shpallur nga OKB si Viti Ndërkombëtar i Zhvillimit të Turizmit të qëndrueshëm

Përse turizmi? Sepse turizmi sjell rritje ekonomike të qëndrueshme

- * 4% ose më shumë rritje vjetore në numrin ndërkombëtar të mbërritjeve të turistëve që nga 2009
- * 7% e eksportit total dhe 30 % e shërbimeve botërore të eksporteve
- * 1.5 trilion dollarë në eksporte nga turizmi ndërkombëtar në 2015
- * 10 % e GDP ne botë

Turizmi siguron punësim, redukton varfërinë

- * Një në 11 vende pune në gjithë globin
- * Është kategoria më e madhe e eksporteve në shumë vende në zhvillim
- * 57% e mbërritjeve turistëve në botë në 2030 do të jetë ne ekonomitë në zhvillim
- * Pothuaj dyfishi i të punësuarve gra në krahasim me gjithë sektorët e tjerë

Eficientë të burimeve, mbrojtje mjedisi dhe klime

- * Synon reduktojë çlirimet e dioksidit të karbonit në botë në 5%
- * Rrit financimet për mbrojtjen e trashëgimisë, gjallesave dhe mjedisit
- * Mbron dhe rigjallëron biodiversitetin
- * Synon të menaxhojë në mënyrë të qëndrueshme një rritje të turistëve ndërkombëtarë me 1.8 miliardë në 2030.

Pronësia intelektuale, diskutohet bashkëpunimi me biznesin për vitin 2017



Bashkëpunimi ndërinstytucional është një nga pikat kyçe për zbatimin e suksesshëm të Strategjisë Kombëtare mbi Pronësinë Intelektuale 2016-2020 si dhe objektiv kryesor i kësaj strategjie. Për këtë qëllim, në ambientet e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë u zhvillua një takim ku morën pjesë DPPM, e përfaqësuar nga Drejtoresha e Drejtorisë së Koordinimit, Promovimit të PI-së dhe Trajnimeve zj. Elvanda Meçe, ZSHDA e përfaqësuar nga znj. Sonila Meka, Kryetari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, z.Nikolin Jaka, si dhe znj. Albana Laknori, Drejtore e Çështjeve juridike të DHTIT. Në kuadër të aktiviteteve parashikuara në Strategji, aktivitetet me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, janë intensive me qëllim ndërgjegjësimin dhe informimin e komunitetit të biznesit mbi rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të Pronësisë Intelektuale. Gjatë takimit u diskutua kryesisht mundësia e bashkëpunimit edhe në vitin 2017 duke organizuar aktivitete të përbashkëta ndërgjegjësuere për biznesin, mbi rëndësinë e mbrojtjes së pronësisë intelektuale dhe krijimin e kulturës së konkurrencës së ndershme.

Drejtorja e Përgjithshme e Standardizimit publikon tre standarde të rinj

Drejtorja e Përgjithshme e Standardizimit ka publikuar në këtë fillim viti tre standarde të rinj, të cilat vihen në dispozicion të biznesit dhe mund të përdoren prej tij. Standardi i parë është SSH EN 572-2:2012 “Xhami në ndërtim- Produktet silikate të qelqta që përmbajnë sodë inorganike kalciumi - Pjesa 2- Fletë xhami”. Ky standard specifikon kërkesat dimensionale dhe cilësitë minimale (në lidhje me difektet optike dhe visuelle), të fletëve të xhamit (xham float), siç përcaktohet në standardin SSH EN 572-1:2012 për përdorim në ndërtesa. Ky standard zbatohet vetëm në fletët e xhamit të madhësive të mëdha, madhësive të ndryshme nga ato që mbulohen nga ky standard. Standardi i dytë është ndara dhe për pllaka të mëdha. Standardi SSH EN 572-8 jep informacion për fletët e xhamit të madhësive të ndryshme nga ato që mbulohen nga ky standard. SSH EN 13781:2012 “Helmetat mbrojtëse për drejtuesit dhe pasagjerët e mjeteve motorike që lëvizin në dëborë dhe të slitave të garave”. Ky standard përcakton kërkesat dhe metodat e provës për drejtuesit dhe pasagjerët e mjeteve motorike që lëvizin në dëborë dhe të slitave të garave. Ndërsa, standardi i tretë është SSH EN ISO 6781-3:2015 “Zbulimi i parregullsisë, të nxehësisë, të ajrit dhe lagështisë në ndërtesa me metodat infra të kuqe - Pjesa 3: Kualifikimet për operatorët e pajisjeve, analistët e të dhënave dhe hartuesit e raporteve (ISO 6781-3: 2015)”. Kjo pjesë e ISO 6781 specifikon kualifikimet dhe një proces vlerësimi për personelin që (i) kryen kontrollin termografik në ndërtesa (ii) interpreton të dhënat që dalin nga kontrollin termografik (iii) raporton rezultatet e kontrolleve termografike në tre klasifikime. Ky standard siguron bazën për një deklaratë të konformitetit të njohurive, shkathtësisë dhe aftësisë të individëve për të kryer matjet termografike dhe analizat për ndërtesat e banimit, tregtare dhe institucionale.



Adresa: Blvd. “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, Albania

Tel. / Fax: +355 42 22 34 55 / +355 42 22 34 55

E-mail: zmp@ekonomia.gov.al

Web: www.ekonomia.gov.al

